



Drejtuar
Drejtorit dhe aktivitet të Matematicienëve
përmes _____

Lënda: Njoftim për garën Ndërkombëtare matematikore KENGUR PA KUFIJ-2023
23.3.2023

GARA KENGUR DHE GARAT NË MATEMATIKË

Tema mbi të cilën mund të shkruhen artikuj dhe doktoratura në matematikës dhe në fusha të tjera jo vetëm në Maqedoni por edhe në të gjithë botën. Gara Kengur nga ana e shtetit, te paktën e citojnë kështu, trajtohet si lojë matematikore... Por a është kështu....Kjo është pyetja kryesore...Në një sërë vendesh tashmë ka kundërshtarë të ashpër të kësaj teze. Në kushtet në të cilat mbahet, nuk mund asesi të ketë trajtim loje. Në përgjithësi në garën Kengurit marin pjesë shumë pjesmarës (mbi 6 meleonë). Kjo garë pa dyshim e zhvillon logjikën tek të gjithë pjesmarësit. **Kërkohet mënyrë si Kenguri të marrë vendin që meriton, nëse merret parasysh se Kenguri nuk është garë e përbërë nga matematicienët vendas.** Është një garë që i prek të gjitha disiplinat dhe kështu duhet trajtuar.

AKREDITIMET PËR GARËN NDËRKOMBËTARE KENGURI

Ashtu si në të gjitha garat ndërkombëtare, edhe për konkursin KENGURI PA KUFIJ nuk janë të nevojshme akreditime të brendshme. I vetmi akreditim është ai që kemi marrë nga ASAMBLEJA E KENGURIT dhe mund t'ia dërgojmë kujtdo që ka nevojë. Për këtë duhet të na drejtoheni me email. Rregullativa jonë nuk mund dhe nuk guxon të pengojë në asnjë bazë këtë garë që të mbahet, si dhe çdo garë ndërkombëtare në përgjithësi. Ky do të ishte akti më i madh antidemokratik që mund të ndodhë në një shtet.

ORGANIZIMI I GARËS PËR VITIN 2023

Si çdo vit shkollor, edhe këtë vit shkollor organizohet gara ndërkombëtare Kenguri 2023. Krahasuar me vitet e kaluara, këtë vit ky konkurs mbahet në **KUSHTE TË NDRYSHME TË RËNDËSISHME. Nga teksti i kësaj letre dhe letrës tjetër që do të vijojë jo shumë kohë pas kësaj letre, do të konkludohet se për çfarë bëhet fjalë.**

Gara do të mbahet më 23.03.2023, me fillim nga ora 11:00, edhe atë në kategoritë e mëposhtme:

- Kategorja e parë: nxënës nga klasa e 1 e arsimit fillor;
- Kategorja e dytë: nxënës nga klasa e 2-të dhe 3-të të arsimit fillor;
- Kategorja e tretë: nxënës nga klasa e 4-të dhe të 5-të të arsimit fillor;
- Kategorja e katërt: nxënës nga klasa e 6-të dhe 7-të të arsimit fillor;
- Kategorja e pestë: nxënës nga klasa e 8-të dhe 9-të të arsimit fillor;
- Kategorja e gjashtë : nxënës nga viti 1 dhe 2 nga shkollat e mesme;



•Kategoria e shtatë : nxënës nga viti 3 dhe 4 nga shkollat e mesme

Çdo shkollë detyrimisht emëron **mësues përgjegjës** (person përgjegjës nga shkolla).

Paraqitja e nxënësve të bëhet nga mësuesit përgjegjës të cilët do të marrin pjesë në zhvillimin e garës. Për organizim efikas të garës është e këshillueshme të formohen këshilla lokale (për një shkollë ose për disa shkolla bashkë dhe në qoftë se është e mundur për qytetin ose rajonin) me mësues përgjegjës (person përgjegjës) për kontakte.

Për pjesëmarrje në garë çdo nxënës duhet të paguajë 200,00 denarë, për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e garës. Numri minimal i nxënësve në një fletëparaqitje është 10. Një pjesë e të hollave do të mbeten në nivel lokal për organizimin e garës, përkatësisht:

- për pjesëmarrje me më shumë se 300 nxënës, 80 denarë për një pjesëmarrës;
- për pjesëmarrje nga 100 deri 300 nxënës, 65 denarë për një pjesëmarrës ;
- për pjesëmarrje nga 40 deri 99 nxënës , 55 denarë për një pjesëmarrës ;
- për pjesëmarrje nga 10 deri 39 nxënës , 50 denarë për një pjesëmarrës.

Çdo pjesëmarrës në garë tradicionalisht do të fitojë një dhuratë të vogël. Për nxënësit me rezultate më të larta janë parashikuar çmime, diploma dhe lëvdata. **Çdo mësues mentor i nxënësve do të marrë vërtetim (certifikatë) për pjesëmarrje në garë si mentor.** Çdo shkollë e cila ka pjesëmarrës në garë do të pajiset me dokumentacion përkatës për mbajtjen e garës.

Për realizimin efikas të garës , afati për paraqitje në pjesëmarrje dhe pagimi i të hollave duhet të bëhet deri më 14 mars 2023 (pagesa e të hollave të bëhet në grupe, ndërsa individualisht deri më 12.03.2023).

Paraqitja për pjesëmarrje dhe komunikimi të bëhet detyrimisht në mënyrë elektronike në e-mail : kangaroo.macedonia@gmail.com të shkruara në **tabela Excel** me **8 grafe** që duhet të jenë në këtë radhë: **Numri rendor, emri dhe mbiemri i nxënësit garues (në një graf), klasa, shkolla, qyteti, vendbanimi (TË DHËNAT TË SHËNOHEN ME MBËSHTETJE MAQEDONISE: alfabetin që ka vetë sistemi) emri dhe mbiemri i mentorit të studentit (dokumenti në format PDF do të publikohet në faqet përkatëse), si dhe e-mail i detyrueshëm i nxënësit.** Në të njëjtin dokument të përcaktohet edhe **mësuesi përgjegjës** me emër dhe mbiemër të plotë dhe numrat e telefonave (në punë dhe celulari).

Të dhënat e nxënësve dhe shkollës duhet të shkruhen saktë me qëllim që diplomat të jenë të besueshme. Në të kundërt korrigjimet e tyre (diploma, çertifikata) **nuk do të bëhen.**

Në porosinë dhe në fletëpagesën e të hollave të shënohet emri dhe mbiemri i personit që bën pagesën, sasinë e të hollave dhe data e pagesës si dhe shkolla dhe qyteti për të cilën është bërë pagesa me shënimin për KENGUR 2023.

Gara ashtu si vitin e kaluar do të mbahet në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe. Në qoftë se do të ketë pjesëmarrës në numër të mjaftueshëm nxënësish nga nacionalitetet e tjera gara do të mbahet edhe në gjuhët të tjera mësimi. Numri minimal për realizimin e garës në gjuhën amtare të pjesëmarrësve të paraqitur është 1000 në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në të gjitha kategoritë së bashku.



Ju bëjmë me dije se gara ka karakter ndërkombëtar dhe deri tani diplomat, lëvdatat dhe vërtetimet e fituara në këtë garë vlerësohen për regjistrim në shkollat e mesme dhe në disa fakultete, **VEÇANËRISHT NË UNIVERSITETET JASHTË VENDIT duke përfshirë më prestigjiozët.**

Personi për kontakt: Aleksa Malçeski, 076 220 414 çdo DITË nga ora 12:00 deri ne 14:00.

Këtë vit shkollor në disa shkolla, do të dërgohen pjesëmarrës në garë delegatë-mbikëqyrës në garë si dhe do të ketë një sistem tjetër për organizimin e garës.

Në çdo fletëparaqitje të shënohet emri dhe mbiemri i saktë i DREJTORIT të shkollës.

RUNDI I DYTË I KENGURIT

Në kuadër të aktiviteteve, e sidomos për shkak të numrit të madh të pjesëmarrësve, në mënyrë krejtësisht identike për sa i përket punës së studentëve organizohet edhe raundi i dytë i Kengurit. Vendimi është marrë nga **KONSORCIUM I KENGURIT. Pjesa e dytë e Kengurit 2023 është absolutisht e pavarur nga pjesa e parë e KENGURIT 2023.** Në kuadër të aktiviteteve me thirrje publike çdo student nga pjesa e parë e kësaj gare, që mund të gjendet në listat që do të bëhen publike, mund të aplikojë publikisht përmes mjeteve të komunikimit për këtë garë. Në të njëjtën kohë, sigurisht që merren parasysh edhe aplikimet nga mësuesit dhe shkollat që duan të marrin pjesë në këtë pjesë të garës. Çmimi për këtë garë është 350 denarë. Në të njëjtën kohë, nëse shkollat dhe mësuesit aplikojnë me nxënësit e tyre, 90 denarë mbeten në llogarinë e organizatorit lokal dhe pjesa tjetër kalon në llogarinë e organizatorit të garës.

Në këtë pjesë të garës do të ketë shpallje publike dhe shpërndarje publike të medaljeve për më meritoret si në vitet e kaluara.

OLIMPJADA MATEMATIKE MAQEDONASE VITI 2023

Ashtu si vitin e kaluar dhe këtë vit do të mbahet Olimpijada matematikor Maqedonase për nxënësit nga klasa e parë deri në të 6. Detajet për këtë do të tregohen në kohën e duhur.

PJESA E PARË SPECIALE E AKTIVITETEVE-EKSKURSIONI KENGURI 2023

Nëse numri i pjesëmarrësve në garën Kengur që do të organizohet më 23.03.2023 është jo më pak se 10000 dhe jo më shumë se 15000, do të organizohet ekskursion veror njëditor. Ekskursioni do të jetë brenda Republikës së Maqedonisë ose në një nga vendet më të afërta fqinje. Sigurisht që do të vizitohen disa nga monumentet më të rëndësishme kulturore dhe historike. Numri i pjesëmarrësve është maksimumi 50. Të drejtën e zgjedhjes e ka **KONSORCIUMI-KENGUR PA KUFIJ.**

PJESA E DYTË SPECIALE E AKTIVITETEVE - KAMP VEROR KENGURI 2023

Nga nxënësit pjesëmarrës në raundin e dytë të Kengurit 2023, nëse numri i pjesëmarrësve është më shumë se 15000 në pjesën e parë të Kengurit 2023 që do të organizohet më 23.03.2023, nuk do të organizohet asnjë ekskursion, por do të organizohet kamp veror lokal. Numri i pjesëmarrësve, për shkak të çmimit të ulët të kësaj gare do të jetë i vogël. Numri më i madh i pjesëmarrësve është

1. 10-15 për numrin e garuesve në raundin e parë të Kengurit nga 15001-20000
2. 15-20 për numrin e garuesve në raundin e parë të Kengurit mbi 20.000.

Kampi veror do të përfundojë me një testim, në të cilin do të shpallet nxënësi më i mirë i KENGURIT 2023.

KENGUR PA KUFIJ 2021
tel. 076 220414
e-mail: kangaroo.macedonia@gmail.com
rr. 2 nr.107A
Lagjja Vizbeg Shkup,
Republika e Maqedonisë së V.



KANGAROO SANS FRONTIERES 2019
tel. 076 220 414
e-mail: kangaroo.macedonia@gmail.com
str.2 nom. 107A
District Vizbegovo, Skopje,
Republik of H. Macedonia

Është e mundur kampi të organizohet në një nga vendet fqinje. Të drejtën e zgjedhjes së skuadrave për kampin veror e kanë **KONSORCIUMI-KENGUR PA KUFIJ.**

PAGESA PËR KENGUR 2023

Pagesa për Kengur 2023 është e ndryshme nga pagesa e vitit të kaluar për Kengur. Këtë vit mjetet duhet të paguhen në llogari

Ilogari bankare	200003239674086
NVA	4057017538981
Banka Deponent	Stopnska Banka SHA-Shkup
Shoqëria natyrore matematikore	ARMAGANKA

Mjetet për garën e paguar në ndonjë llogari tjetër ose në ndonjë bankë tjetër nuk do të merren parasysh dhe nuk do të organizohet garë në atë shkollë.

Kryetar

Aleksa Mallçeski

Profesore e rregullt në FMSH

Kryetare e Bordit të Armagankës për KENGUR